



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosova
Qeveria - Vlada - Government

**RREGULLORE (QRK) NR. 08/2024 PËR STEMËN DHE VULËN E ZYRËS SË
INSPEKTORIT TË PËRGJITHSHËM DHE ORGANEVE INSPEKTUESE SI
DHE PËR DOKUMENTIN E IDENTIFIKIMIT TË INSPEKTORËVE TË
REPUBLIKËS SË KOSOVËS¹**

¹ Rregullore (QRK) Nr. 08/2024 për Stemën dhe Vulën e Zyrës së Inspektorit të Përgjithshëm dhe Organeve Inspektuese si dhe për Dokumentin e Identifikimit të Inspektorëve të Republikës së Kosovës, është miratuar në mbledhjen e 198-të, të Qeverisë së Republikës së Kosovës me Vendimin Nr. 05/198, të datës 02.04.2024.

Qeveria e Republikës së Kosovës,

Në mbështetje të nenit 93 (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 15 paragrafit 4 të Ligjit Nr. 08/L-067 për Inspektimet, nenit 8 paragrafit 4 nën-paragrafit 4.5 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës dhe nenit 19 paragrafit 6 nën-paragrafit 6.2 të Rregullores Nr. 09/2011 së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës,

Nxjerr:

RREGULLORE (QRK) NR. 08/2024 PËR STEMËN DHE VULËN E ZYRËS SË INSPEKTORIT TË PËRGJITHSHËM DHE ORGANEVE INSPEKTUESE SI DHE PËR DOKUMENTIN E IDENTIFIKIMIT TË INSPEKTORËVE TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS

KAPITULLI I DISPOZITAT E PËRGJITHSHME

Neni 1 Qëllimi

Kjo rregullore ka për qëllim përcaktimin e formës, përmbajtjes, pajisjes dhe mënyrës së përdorimit të stemës dhe vulës nga personeli i Zyrës së Inspektorit të Përgjithshëm dhe i organeve inspektuese si dhe dokumentit të identifikimit nga inspektorët e institucioneve të Republikës së Kosovës.

Neni 2 Fushëveprimi

1. Kjo rregullore zbatohet për personelin e Zyrës së Inspektorit të Përgjithshëm dhe të organeve inspektuese për stemën dhe vulën. Poashtu, rregullorja zbatohet edhe për inspektorët e Republikës së Kosovës sa i përket dokumentit të tyre të identifikimit.

2. Përfundimisht nga paragrafi 1 i këtij neni, kjo rregullore nuk zbatohet për:

- 2.1. inspektimin doganor dhe tatimor;
- 2.2. inspektimin për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimin e terrorizmit;
- 2.3. inspektimin e brendshëm me karakter administrativ në administratën shtetërore dhe komunale;
- 2.4. inspektimet nga inspektorati policor; dhe

2.5. inspektimet për siguri publike në kuadër të ministrisë përgjegjëse për punët e brendshme.

Neni 3 Përkufizimet

1. Për qëllime të kësaj rregulloreje, shprehjet e përdorura kanë këtë kuptim:

1.1. **Zyra e Inspektorit të Përgjithshëm** nënkupton agjencinë ekzekutive në kuadër të Zyrës së Kryeministrit të Republikës së Kosovës;

1.2. **Organet inspektuese** nënkuptojnë inspektoratet qendrore dhe njësitë e veçanta inspektuese që funksionojnë në kuadër të administratës shtetërore si dhe inspektoratet komunale që funksionojnë në nivel komunal;

1.3. **Inspektor** nënkupton zyrtarin publik që është nëpunës civil dhe i cili merret me mbikëqyrjen e zbatimit të legjislacionit si dhe është kompetent për zhvillimin e inspektimeve sipas legjislacionit në fuqi;

1.4. **Stema** nënkupton përcaktimin grafik të shenjës identifikuese të institucionit që e dallon atë nga një institucion tjetër;

1.5. **Vula** nënkupton mjetin me ngjyrë që mundëson vërtetimin e autenticitetit të një dokumenti, përkatësisht shkresë zyrtare; dhe

1.6. **Dokumenti i identifikimit** nënkupton kartelën e cila legjitimon dhe mvesh me autorizime përkatëse përdoruesin e saj.

KAPITULLI II

STEMA E ZYRËS SË INSPEKTORIT TË PËRGJITHSHËM DHE ORGANEVE INSPEKTUESE

Neni 4

Forma e stemës së Zyrës së Inspektorit të Përgjithshëm dhe të organeve inspektuese

1. Forma e stemës së Zyrës së Inspektorit të Përgjithshëm përcaktohet si në shtojcën 1 të kësaj rregulloreje.

2. Forma e stemave të organeve inspektuese është me proporcione të njëjta sikurse forma e stemës së Zyrës së Inspektorit të Përgjithshëm. Nuancat dhe tipografia e stemave të organeve inspektuese përcaktohen me udhëzuesin për dizajnimin e stemës që hartohet nga Zyra e Inspektorit të Përgjithshëm.

Neni 5

Përmbajtja e stemës së Zyrës së Inspektorit të Përgjithshëm dhe të organeve inspektuese

Stema e Zyrës së Inspektorit të Përgjithshëm dhe stemat e organeve inspektuese si shenja grafike përmbajnë elemente figurative të cilat pasqyrojnë rëndësinë, imazhin dhe funksionin e Zyrës së Inspektorit të Përgjithshëm dhe të organeve inspektuese veç e veç.

Neni 6

Pajisja me stemë e Zyrës së Inspektorit të Përgjithshëm dhe e organeve inspektuese

1. Zyra e Inspektorit të Përgjithshëm pajiset me stemën e saj drejtpërdrejtë përmes kësaj rregulloreje, sikurse përcaktohet në shtojcën 1 të kësaj rregulloreje.
2. Organet inspektuese dërgojnë propozimet e tyre përkatëse për stemë pranë Zyrës së Inspektorit të Përgjithshëm.
3. Në pajtim me paragrafin 2 të këtij neni, Zyra e Inspektorit të Përgjithshëm ofron pëlqim me shkrim për propozimin e dërguar nga organet inspektuese apo dërgon propozime konkrete mbi nevojën e përmirësimit të stemës së propozuar.

Neni 7

Mënyra e përdorimit të stemës nga Zyra e Inspektorit të Përgjithshëm dhe nga organet inspektuese

1. Zyra e Inspektorit të Përgjithshëm dhe organet inspektuese përdorin stemën përkatëse në të gjitha dokumentet zyrtare, përfshirë edhe në komunikimet përmes shkresave zyrtare.
2. Stema e Zyrës së Inspektorit të Përgjithshëm përdoret ekskluzivisht nga Zyra e Inspektorit të Përgjithshëm dhe stemat përkatëse të organeve inspektuese përdoren ekskluzivisht nga organet inspektuese përkatëse.
3. Stema e Zyrës së Inspektorit të Përgjithshëm dhe e organeve inspektuese vendoset në anën e djathtë të dokumentit, përkatësisht të shkresës, krahas stemës së Republikës së Kosovës e cila vendoset në anën e majtë të dokumentit, përkatësisht të shkresës.
4. Përrjashtimisht paragrafit 3 të këtij neni, stema e organeve inspektuese në nivel lokal vendoset në anën e djathtë të dokumentit, përkatësisht shkresës, krahas stemës së komunës përkatëse e cila vendoset në anën e majtë të dokumentit, përkatësisht shkresës.
5. Zyra e Inspektorit të Përgjithshëm dhe organet inspektuese mund t'a përdorin stemën në madhësi tjetër nga ajo e përcaktuar me shtojcën 1 të kësaj rregulloreje dhe varësisht nga dokumentet, përkatësisht shkresat, por duke mos i cenuar proporcionet midis elementeve të ndryshme të stemës.
6. Stema e përcaktuar me shtojcën 1 të kësaj rregulloreje mund të përdoret edhe në versionin bardh e zi.

7. Detajet tjera teknike për mënyrën e përdorimit të stemave nga organet inspektuese përcaktohen me udhëzuesin e përcaktuar në paragrafin 2 të nenit 4 të kësaj rregulloreje.

KAPITULLI III VULA E ZYRËS SË INSPEKTORIT TË PËRGJITHSHËM DHE ORGANEVE INSPEKTUESE

Neni 8

Forma e vulës së Zyrës së Inspektorit të Përgjithshëm dhe organeve inspektuese

1. Vulat e Zyrës së Inspektorit të Përgjithshëm dhe organeve inspektuese kanë formë rrethore.
2. Përjashtimisht nga paragrafi 1 i këtij neni dhe për protokollimin e shkresave, Zyra e Inspektorit të Përgjithshëm dhe organet inspektuese mund të pajisen edhe me vula në formë katrore.

Neni 9

Përmbajtja e vulës së Zyrës së Inspektorit të Përgjithshëm dhe organeve inspektuese

1. Vula rrethore e Zyrës së Inspektorit të Përgjithshëm, e cila përbëhet nga disa rrathë koncentrik, përmban të dhënat vijuese:
 - 1.1. në rrethin e parë të jashtëm vendoset mbishkrimi “Republika e Kosovës”;
 - 1.2. në rrathët tjerë vendoset mbishkrimi “Zyra e Inspektorit të Përgjithshëm”;
 - 1.3. në mes të vulës rrethore vendoset shenja e stemës së Republikës së Kosovës; dhe
 - 1.4. selia e Zyrës së Inspektorit të Përgjithshëm mund të shkruhet në vazhdim të mbishkrimit “Zyra e Inspektorit të Përgjithshëm” ose në fund të shenjës së stemës së Republikës së Kosovës.
2. Vulat rrethore përkatëse të organeve inspektuese, të cilat përbëhen nga disa rrathë koncentrik, përmbajnë të dhënat vijuese:
 - 2.1. në rrethin e parë të jashtëm vendoset emërtimi “Republika e Kosovës”;
 - 2.2. në rrathët tjerë vendoset mbishkrimi i emrit të organit inspektues;
 - 2.3. në mes të vulës rrethore vendoset shenja e stemës së Republikës së Kosovës;
 - 2.4. selia e organit inspektues mund të shkruhet në vazhdim të mbrishkrimit të emrit të organit inspektues ose në fund të shenjës së stemës së Republikës së Kosovës.
3. Përjashtimisht nga paragrafët 1 dhe 2 të këtij neni, Zyra e Inspektorit të Përgjithshëm dhe organet inspektuese mund të posedojnë më shumë se një vulë rrethore. Në rastet kur këto institucione posedojnë

më shumë se një vulë rrethore, atëherë ato shënohen me numra romak të ciët vendosen në mes të stemës së Republikës së Kosovës dhe selisë së Zyrës së Inspektorit të Përgjithshëm, respektivisht të organeve inspektuese.

4. Përrjashtimisht nga paragrafi 2 i këtij neni, organet inspektuese në nivel komunal kanë të drejtë të përdorin vulën rrethore me stemën e komunës së tyre përkatëse kur nuk kryejnë detyra të veçanta, përkatësisht detyra nga kompetencat shtetërore, në pajtim me Ligjin për përdorimin e simboleve shtetërore të Kosovës dhe Ligjin për vetëqeverisjen lokale.

5. Vula katrore e Zyrës së Inspektorit të Përgjithshëm përmban të dhënat vijuese, sipas radhitjes:

5.1. në pjesën e sipërme në anën e majtë të vulës katrore vendoset stema e Republikës së Kosovës;

5.2. në pjesën e sipërme në anën e djathtë të vulës katrore vendoset stema e Zyrës së Inspektorit të Përgjithshëm;

5.3. nën stemën e Republikës së Kosovës vendoset mbishkrimi “Republika e Kosovës”;

5.4. vendoset mbishkrimi “Zyra e Kryeministrit” me shkronja të mëdha të shtypit;

5.5. vendoset mbishkrimi “Zyra e Inspektorit të Përgjithshëm”;

5.6. vendoset numri i protokollit i Zyrës së Inspektorit të Përgjithshëm dhe në vazhdim lihet hapësira për shënimin e protokollit të shkresës;

5.7. vendoset hapësira për shënimin e numrit të faqeve të bashkëngjitura;

5.8. vendoset hapësira për shënimin e ditës, muajit dhe vitit; dhe

5.9. vendoset emri i vendit të selisë së institucionit nën varësi të të cilit ndodhet Zyra e Inspektorit të Përgjithshëm.

6. Vulat katrore të organeve inspektuese përmbajnë të dhënat vijuese, sipas radhitjes:

6.1. në pjesën e sipërme në anën e majtë të vulës katrore vendoset stema e Republikës së Kosovës;

6.2. në pjesën e sipërme në anën e djathtë të vulës katrore vendoset stema e organit inspektues;

6.3. nën stemën e Republikës së Kosovës vendoset mbishkrimi “Republika e Kosovës”;

6.4. vendoset mbishkrimi i emrit të institucionit nën varësi të të cilit ndodhet organi inspektues, me shkronja të mëdha të shtypit;

6.5. vendoset mbishkrimi i emrit të organit inspektues;

6.6. vendoset numri i protokollit të organit inspektues dhe në vazhdim lihet hapësira për shënimin e protokollit të shkresës;

6.7. vendoset hapësira për shënimin e numrit të faqeve të bashkëngjitura;

6.8. vendoset hapësira për shënimin e ditës, muajit dhe vitit; dhe

6.9. vendoset emri i vendit të selisë së institucionit nën varësi të të cilit ndodhet organi inspektues.

7. Teksti i vulës së institucionit shkruhet me shkronja të mëdha të shtypit në madhësi dhe formë të njëjtë në pajtim me legjislacionin për përdorimin e gjuhëve zyrtare të Republikës së Kosovës.

8. Në pajtim me Ligjin për vetëqeverisjen lokale, organet inspektuese në nivel komunal përdorin vulën që përfshin shenjën dhe emrin e komunës.

Neni 10

Pajisja me vulë e Zyrës së Inspektorit të Përgjithshëm dhe organeve inspektuese

1. Zyra e Inspektorit të Përgjithshëm dhe organet inspektuese mund të pajisen me vulë pas parashtrimit të kërkesës pranë ministrisë përgjegjëse për administratë publike.

2. Kërkesa pranë ministrisë përgjegjëse për administratë publike për pajisje me vulë parashtrohet përmes formularit përkatës të përcaktuar me akt nënligjor të nxjerrë në pajtim me Ligjin për vula në institucionet e Republikës së Kosovës.

3. Në rast se Zyra e Inspektorit të Përgjithshëm apo organet inspektuese ushtrojnë veprimtaritë e tyre në më shumë se një ndërtesë dhe nëse është e arsyeshme në pajtim me kërkesat e punës, atëherë ato kanë të drejtë të kenë më shumë ekzemplarë të vulave.

Neni 11

Mënyra e përdorimit të vulës nga Zyra e Inspektorit të Përgjithshëm dhe organet inspektuese

1. Inspektori i Përgjithshëm i Zyrës së Inspektorit të Përgjithshëm apo udhëheqësi i organit inspektues, pas pranimi të vulës nga ministria përgjegjëse për administratë publike, nxjerr vendim për datën e fillimit të përdorimit të vulës.

2. Inspektori i Përgjithshëm i Zyrës së Inspektorit të Përgjithshëm apo udhëheqësi i organit inspektues autorizon me shkrim zyrtarin përgjegjës për përdorimin e vulës. Nëse zyrtari përgjegjës i autorizuar mungon përkohësisht, atëherë Inspektori i Përgjithshëm i Zyrës së Inspektorit të Përgjithshëm apo udhëheqësi i organit inspektues autorizon zyrtarin tjetër përkohësisht përgjegjës për vulë.

3. Në pajtim me paragrafin 2 të këtij neni, personi përgjegjës për vulë mban përgjegjësi për përdorimin e saj dhe e ruan vulën nga shfrytëzimi i pautorizuar.

4. Zyrtari përgjegjës për përdorimin e vulës pranë Zyrës së Inspektorit të Përgjithshëm apo pranë organit inspektues, mban evidencë të plotë dhe të saktë si dhe një kopje të dokumentit të vulosur.
5. Vula e Zyrës së Inspektorit të Përgjithshëm apo e organit inspektues përdoret vetëm brenda selisë së institucionit.
6. Përgjithshëm paragrafit 5 të këtij neni, vula mund të përdoret edhe jashtë selisë së institucionit me autorizim të veçantë nga Inspektori i Përgjithshëm i Zyrës së Inspektorit të Përgjithshëm apo udhëheqësi i organit inspektues, respektivisht.
7. Vula ruhet në kasafortë gjatë kohës që nuk përdoret apo jashtë orarit të punës.
8. Në rast se vula humb apo nuk mund të përdoret tutje, atëherë lajmërohet menjëherë Inspektori i Përgjithshëm i Zyrës së Inspektorit të Përgjithshëm apo udhëheqësi i organit inspektues, respektivisht si dhe ministria përgjegjëse për administratë publike. Afati për lajmërim nuk mund të jetë më i gjatë se njëzet e katër (24) orë.
9. Në pajtim me paragrafin 8 të këtij neni, Inspektori i Përgjithshëm i Zyrës së Inspektorit të Përgjithshëm ose udhëheqësi i organit inspektues pas konstatimit të humbjes së vulës apo të pamundësisë për përdorim të mëtutjeshëm, me vendim të menjëhershëm e shpall të pavlefshme vulën në fjalë.
10. Në rast të mos-përdorimit të drejtë të vulës, zbatohen sanksionet kundërvajtëse për institucionin dhe/apo titullarin e institucionit të parapara me Ligjin për vula në institucionet e Republikës së Kosovës.

KAPITULLI IV

DOKUMENTI I IDENTIFIKIMIT PËR INSPEKTORËT

Neni 12

Forma e dokumentit të identifikimit për inspektorët

Forma e dokumentit të identifikimit për inspektorët është e llojit të kartelës dhe është e ngjashme me formën e dokumenteve të identifikimit për të gjithë zyrtarët publik, në pajtim me legjislacionin në fuqi.

Neni 13

Përmbajtja e dokumentit të identifikimit të inspektorëve

1. Dokumenti i identifikimit të inspektorëve përmban të dhënat vijuese:

1.1. Stemën e Republikës së Kosovës;

1.2. Stemën e Zyrës së Inspektorit të Përgjithshëm apo të organit inspektues, përshtatshëm;

1.3. Mbishkrimin « Republika e Kosovës », « Zyra e Kryeministrit » dhe « Zyra e Inspektorit të Përgjithshëm apo « Republika e Kosovës » dhe emri i organit inspektues, përshtatshëm;

1.4. fotografinë e inspektorit;

1.5. emrin dhe mbiemrin e inspektorit;

1.6. titullin e inspektorit;

1.7. numrin e dokumentit të identifikimit;

1.8. afatin e dokumentit të identifikimit;

1.9. në pjesën e pasme të kartelës mbishkrimin “Inspektori autorizohet të ketë qasje tek të gjithë personat juridik dhe fizik që janë subjekt i inspektimit dhe që bie nën fushëveprimtarinë e organit inspektues të cilit i shërben inspektori”.

2. Në pajtim me paragrafin 1 të këtij neni, stema e Republikës së Kosovës vendoset në anën e majtë të dokumentit të identifikimit ndërsa stema e organit inspektues vendoset në anën e djathtë, shikuar përpara.

3. Dokumenti i identifikimit shkruhet në gjuhët zyrtare, në pajtim me Ligjin për përdorimin e Gjuhëve.

Neni 14

Pajisja me dokument të identifikimit të inspektorëve

1. Pajisjen me dokument të identifikimit të inspektorëve e bën ministria përgjegjëse për administratë publike.

2. Kërkesa për pajisje me dokument të identifikimit dorëzohet pranë ministrisë përgjegjëse për administratë publike përmes formularit të përcaktuar me legjislacionin përkatës.

3. Në pajtim me paragrafin 2 të këtij neni, kërkesa dorëzohet nga njësia përgjegjëse për burime njerëzore e institucionit përkatës.

4. Në rast të ndërrimit të pozitës, dëmtimit të dokumentit të identifikimit apo kalimit të afatit të dokumentit të identifikimit, njësia përgjegjëse për burime njerëzore e dorëzon kërkesën e re në pajtim me paragrafët 2 dhe 3 të këtij neni, duke e bashkëngjitur dokumentin e mëparshëm të identifikimit.

5. Në rast të humbjes së dokumentit të identifikimit, inspektori paraqet rastin tek policia e Kosovës dhe pastaj njofton me shkresë njësinë përgjegjëse për burime njerëzore të institucionit vetanak duke specifikuar vendin, ditën e humbjes së dokumentit të identifikimit dhe duke bashkëngjitur proces verbalin e policisë së Kosovës.

6. Në pajtim me paragrafin 2 dhe 5 të këtij neni, njësia përgjegjëse për burime njerëzore dorëzon kërkesën e re për pajisje me dokument të identifikimit.

Neni 15
Mënyra e përdorimit të dokumentit të identifikimit nga inspektorët

1. Inspektorët e Republikës së Kosovës duhet t'a bartin me vete dhe në vend të dukshëm dokumentin e identifikimit gjatë orarit të punës në ndërtesat e institucioneve të Republikës së Kosovës si dhe gjatë hyrjes dhe qëndrimit tek subjektet e inspektimit.
2. Dhënia në shfrytëzim e dokumentit të identifikimit personit tjetër paraqet shkelje të rëndë të detyrave të punës dhe ndëshkohet në pajtim me legjislacionin në fuqi për keqpërdorimin e detyrës zyrtare dhe falsikim të dokumenteve.
3. Në rast të ndërprerjes apo përfundimit të marrëdhënies së punës, inspektori dorëzon dokumentin e identifikimit në njësinë përgjegjëse për burime njerëzore, e cila pastaj të njëjtin e dorëzon në ministrinë përgjegjëse për administratë publike.
4. Mos dorëzimi i dokumentit të identifikimit dhe posedimi i pa-autorizuar i dokumentit zyrtar të identifikimit sanksionohet në pajtim me legjislacionin në fuqi.

KAPITULLI V
DISPOZITAT PËRFUNDIMTARE

Neni 16
Përgjegjësia për zbatim

Mbikëqyrjen për zbatimin e kësaj rregulloreje në vazhdimësi e bëjnë Zyra e Inspektorit të Përgjithshëm dhe të gjitha organet inspektuese.

Neni 17
Shfuqizimi

Me hyrjen në fuqi të kësaj rregulloreje shfuqizohen të gjitha dispozitat e akteve nënligjore që rregullojnë stemat, vulat dhe dokumentet e identifikimit për organet inspektuese.


Neni 18
Hyrja në fuqi

Kjo rregullore hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe publikohet në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI

Kryeministër i Republikës së Kosovës
03 prill 2024

Shtojca 1.



ZIP

ZYRA E INSPEKTORIT TË PËRGJITHSHËM
KANCELARIJA GENERALNOG INSPEKTORA
OFFICE OF THE GENERAL INSPECTOR